



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 767/19 Prot.

Patos, më 28/04/2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 25 PRILL 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve, Njësia Administrative Ruzhdie

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjese publike me temë: “Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Drejtore e financave znj. Mimoza Shtëmbari, Drejtor i të Ardhurave Vendore z. Çajup Refitaj, Drejtore e Projekteve znj. Ermenita Mici, *rreth 18 pjesëmarrës (administrator i njësisë Ruzhdie z. Agim Mesutaj, banor, kryetar të fshatrave etj)*

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2028”, jemi këtu sot për të dëgjuar të gjitha kërkesat që ju si njësi keni. Jeni të lutur t’i paraqisni këto kërkesa kundrejt bashkisë në mënyrë që secila prej tyre të merret në konsideratë.

Administrator i njësisë Ruzhdie, z. Agim Mesutaj– përshëndetje të gjithëve! Lidhur me kërkesat e Ruzhdies dua ta filloj me Gjynoqarën pasi rruga nga qendra e Gjynoqarës deri te



**Administrator i njësisë Ruzhdie
z. Agim Mesutaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Manxharaj nuk është futur në projekt për tu shtruar. Problemet e tjera lidhen me rrugët e traktorëve në parcelat bujqësore. Lidhur me ndriçimin nuk e di nëse është planifikuar nga qendra deri lart te rruga e re? Për sa i përket fshatit Siqec në marrëveshjen kuadër dy rrugët e lagjes janë miratuar dhe nuk besoj se ka ndonjë tjetër pasi edhe ndriçimi do të vendoset dhe është në proces. Me ujin është problem pasi vazhdon të mos ketë zgjidhje, por kjo është diçka që i përket ujësjellsit.

Në lidhje me Drenien nga Mekani deri lart duhet bërë me beton dhe për të vijuar me Ruzhdien, e cila realisht ka katër lagje dhe rrugët janë karikuar me rërë bituminoze vetëm. Pjesa këtu afër njësisë është në marrëveshjen kuadër dhe ka edhe ndriçimin e përfshirë. Në lagjen e Shkëmbit Ruzhdie, Neveliaj, Memaj, Kocomilit dhe janë rrugët e lagjes që kanë nevojë për ndërhyrje sepse janë edhe rrugët lidhëse të Ruzhdies. Problemi i Kasnicës pothuajse ka marrë një zgjidhje pasi është i vetmi fshat që nga bashkia mori më shumë investim. Për tumbinot është pak problem për sasinë pasi ne kemi shumë kërkesa. Vetëm pesë na duhen në lagjen Manxharaj. Na duhen edhe në vende të tjera.

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli- Lagjja Xhepaj është e përfshirë, rruga e Mekamit, Myftaraj, Cukuvraj, Malaj dhe rrugët bujqësore janë të parashikuara për këtë vit. Gjithashtu

rruga Hysaj, Xhoraj, rrugët e parcelave, rruga e Gjynoqarës dhe rruga Ymeraj janë të përfshira për ndërjyje këtë vit.



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Kryetar i fshatit Siqecë, z. Myftar Sorraj– Ne kemi problemin e taksave vendore me banorët dhe nëse është e mundur për ta diskutuar këtu. Ndriçimin dhe rrugët ju i thatë që janë të përfshira nuk kemi gjë tjetër.



**Kryetar i fshatit Siqecë
z. Myftar Sorraj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Drejtore të ardhurave vendore, z. Çajup Refitaj- Ne duhet të diskutojmë dhe të gjejmë një mekanizëm të përbashkët dhe të mundësojmë një mbledhje të taksave vendore në këtë njësi pasi është një detyrim që duhet shlyer ndaj bashkisë. Gjithashtu duhet të krijojmë një mekanizëm për të afruar banorët ndaj shlyerjes së detyrimit të tyre sepse të gjitha ndërhyrjet që vijnë nga bashkia kanë një kosto. Krahasuar me Zharrëzën ju jeni shumë më ulët, por duhet ta shikojmë në paketën tjetër fiskale që ne të krijojmë edhe për ju një mekanizëm në mbledhjen e të ardhurave.



Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari

Dëgjese publike me temë:

“Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”

Prill 2025

Drejtore e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari- Ne kemi ardhur këtu për të marrë kërkesat tuaja ku keni ju nevojë për ndërhyrje, shërbime apo investime etj. Në rast se ne do të vinim me një bilanc financiar këtu dhe do t’ju thonim se sa ne ju ofrojmë në vlerë financiare dhe sa argëtojmë nga Ruzhdia dhe sa argëtojmë nga Zharrëza do ta pranoni të gjithë që kjo është e drejtë. Taksa paguesit që derdhen taksat e tyre në Zharrëz duhet ti marrin zhërbimet për vete, ndërkohë ne i qarkullojmë për të gjithë dhe i sjellim edhe në Ruzhie. Duhet parë edhe formart shtrënguese, por edhe ato motivuese.



**Drejtore e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

Dëgjese publike me temë:

“Marrja e kërkesave prioritare mbi hartimin e PBA-së 2026-2028”

Prill 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Faleminderit për kërkesat tuaja dhe nëse nuk keni më të tilla për këtë dëgjese publike unë e deklaroj të mbyllur këtë takim dhe do të shihemi në takime të tjera.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak,
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjesë publike me temë:
“Marrja e kërkesave prioritare mbi
hartimin e PBA-së 2026-2028”**

Prill 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

